



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**REFORMA E FINANCIMIT**  
**NË**  
**ARSIMIN E LARTË NË SHQIPËRI**

*(Green Paper –Dokument për Konsultim Publik )*

Tiranë 2010

## **PËRMBAJTJA**

HYRJE.....	3
KREU I: KRITERET E PËRZGJEDHJES SË UNIVERSITETEVE/PROGRAMEVE/ DHE STUDENTËVE .....	3
KREU II: MEKANIZMI I KONKURENCËS SË LIRË - TREGU I “STUDENTËVE” .....	5
KREU III: SKEMA E FINANCIMIT ME BAZË STUDENTIN.....	5
3.1. KUOTAT .....	5
3.2. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË VLERËN E FINANCIMIT.....	7
KREU IV: TARIFAT E SHKOLLIMIT DHE BURSAT E STUDIMIT .....	8
KREU V: SISTEMI I KREDISË STUDENTORE .....	9
KREU VI: FINANCIMI I AKTIVITETEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR .....	9
KREU VII: MENAXHIMI DHE QEVERISJA E UNIVERSITETEVE.....	10
KREU VIII: FONDI PËR ZHVILLIMIN STRATEGJIK TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË .....	11

## HYRJE

Qeveria Shqiptare, në Strategjinë Kombëtare për Arsimin e Lartë (Shtator 2008-2013) deklaroi si objektiv kryesor *rritjen e aksesit të të rinjve shqiptarë në arsimin e lartë si dhe përmirësimin e standarteve dhe cilësisë së tij*. Iniciativa e reformimit të financimit të IAL-ve vihet në fuksion të këtyre objektivave dhe synon të forcojë rolin e arsimit të lartë si faktor kryesor i zhvillimit dhe prosperitetit të vendit. Kjo reformë synon të mbështesë objektivin e rritjes së aksesit dhe cilësisë duke maksimizuar burimet kombëtare që mobilizohen për zhvillimin e arsimit të lartë. Stimulimi i partneritetit publik-privat do të vihet në fuksion të përmirësimit të orientimit të studimeve universitare kah tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Kjo reformë u përgjigjet sfidave dhe zhvillimit të shpejtë të arsimit të lartë si nga ana e kërkesës ashtu dhe nga ajo e ofertës. Liberalizimi i aksesit në arsimin e lartë ka rritur ndjeshëm numrin e studentëve, nderkohë që kërkesa e lartë për arsimim është shoqëruar me rritjen e ndjeshme të kapaciteteve në arsimin publik dhe atë privat. Tendencat e zhvillimit të arsimit të lartë në botë, ku koncepti tradicional i universitetit ka evoluar dhe universitetet janë shndërruar në qendra të hapura të akumulimit dhe shkëmbimit të dijes është gjithashtu një faktor i rëndësishëm në nxitjen e kësaj reforme. Nevoja për ndryshime më rrënjësore në arsimin e lartë është një mësim i nxjerrë nga eksperiencia e vendeve të tjera që kanë implementuar reforma të ngjashme.

Parimi bazë i reformës së financimit do të jetë: *fondet publike ndjekin studentin, në institucionet e arsimit të lartë që ofrojnë përgjatë studimeve një shërbim brenda normave të përcaktuara dhe pranuar të cilësisë*. Me këtë mekanizëm, institucionet e arsimit të lartë përfitojnë fonde publike në bazë të numrit të studentëve të regjistruar të cilët plotësojnë kriteret për përfshirjen në skemën e financimit.

## KREU I: KRITERET E PËRZGJEDHJES SË UNIVERSITETEVE/PROGRAMEVE/DHE STUDENTËVE

**CILËSIA:** Qeveria Shqiptare do të financojë nga fondet publike Institucione të Arsimit të Lartë (publike dhe jopublike) të *cilat kanë arritur në mënyrë të qartë një NIVEL CILËSIE MË TË LARTË SE NIVELI I CILËSISË (PRAG) TË PËRCAKTUAR*. Kjo bëhet për të mbrojtur publikun e gjerë, përfituesit e drejtpërdrejtë (studentët, familjarët e tyre) si dhe fondet publike.

Ky kusht kërkon përcaktimin e një sërë indikatorësh të vlerësimit të cilësisë në arsimin e lartë, i cili të jetë i observueshëm dhe i matshëm në mënyrë të besueshme. Këta indikatorë do të përdoren për të përcaktuar pragun e cilësisë dhe për të identifikuar IAL-të e përshtatshme për tu përfshirë në skemën e financimit me bazë studentin. Qeveria Shqiptare do të mbështetet në sygjerimet e Këshillit të Akreditimit për të përcaktuar “PRAGUN E CILËSISË” të IAL-ve të domozdoshëm për tu përfshirë në skemën e financimit. Si rezultat i rëndësisë absolute që ka sigurimi i cilësisë, paralelisht me reformën financiare në arsimin e lartë dhe në përputhje me kërkesat e Kartës së Bolonjës, Qeveria Shqiptare do të forcojë autoritetin e Këshillit të Akreditimit duke e bërë më rigoroz dhe kërkuar procesin e vlerësimit të cilësisë. Njëkohësisht *debati publik dhe sidomos debati brenda institucioneve të arsimit të lartë mund të ndihmojë në përcaktimin e indikatorëve të cilësisë dhe pragut minimal të tyre*.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me Këshillin e Akreditimit, mbështetur nga ekspertiza ndërkombëtare në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” po punon për të zgjedhur një paketë të tillë treguesish. Disa nga sygjerimet e deritanishme përfshijnë tregues si:

- *programet e akredituara;*
- *numrin e personelit akademik (të punësuar me kohë të plotë) për student (për fushë studimi);*
- *numrin e fakulteteve, departamenteve dhe stafit akademik (sipas nenit 12 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar);*
- *raportin e të diplomuarve që kualifikohen në provimet shtetërore të profesioneve të rregulluara;*
- *sipërfaqen standarte për student;*
- *numri e titujve të librave në bibliotekën e Institucionit të Arsimit të Lartë për student, si dhe*
- *mundësinë e përdorimit të internetit prej studentëve (broadband), etj.*

Vlerësimi aktual i standardeve dhe cilësisë së universiteteve nga Agjensia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) nuk përfshin vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Futja e indikatorëve të matjes së cilësisë së mësimdhënies do të ishte mjaft e vlefshme. Kjo mund të bëhej duke ndërtuar indikatorë mbi natyrën e vlerësimit të arritjeve të studentëve, për shembull, sa përdoret vlerësimi i vazhdueshëm si dhe shkalla në të cilën provimet dhe vlerësimet kërkojnë të testojnë të menduarit kritik dhe jo thjesht faktet e memorizuara. Një tjetër indikator matës i cilësisë së mësimdhënies do të ishte raporti midis orëve në auditorë dhe orëve për punë të pavarur.

Ky prag i cilësisë (i matshëm) do të përdoret për të vlerësuar nëse një Institucion publik ose jopublik i Arsimit të Lartë do të përfshihet në skemën e financimit me bazë studentin. Mund të ndodhë që ndonjë program studimi në ndonjë nga Institucioneve publik të Arsimit të Lartë të mos plotësojë të gjitha normat e përcaktuara të cilësisë. Nisur nga fakti që IAL-të publike janë një aset shumë i rëndësishëm kombëtar, qeveria shqiptare do t’u kërkojë këtyre Institucioneve që për një periudhë të caktuar kohore të përmirësojnë treguesit e cilësisë deri në nivelin e kërkuar. Qeveria Shqiptare do të mbështesë financiarisht IAL-të në këtë përpjekje nëpërmjet Fondit të Zhvillimit Strategjik. Kjo periudhë dhe asistencë financiare për përmirësimin e treguesve të cilësisë parashikohet të jetë 3-vjeçare.

**STATUSI JO-FITIMPRURËS:** Përfshirja e Institucioneve jopublike të Arsimit të Lartë në skemën e financimit me bazë studentin, përveç treguesve të cilësisë do të përcaktohet edhe nga statusi juridik i tyre. **INSTITUCIONET JOPUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DUHET TË JENË TË REGJISTRUARA SI ORGANIZATA JO-FITIMPRURËSE PËR TË PËRFITUAR NGA FONDET PUBLIKE.**

**STUDENTËT QË PËRFITOJNË NGA SKEMA E FINANCIMIT:** Dimensionin i dytë shumë i rëndësishëm i cilësisë ka të bëjë *me studentët e përzgjedhur*. Institucionet e Arsimit të Lartë janë të lirë të vendosin standardet e tyre (kriteret e veçanta) për pranimin e studentëve, por për studentët të cilët do të përfshihen në skemën e financimit do të aplikohet si kriter **NJË KUFI MINIMAL I PIKËVE TË MATURËS SHTETËRORE DHE NOTËS MESATARE TË SHKOLLËS SË MESME**. Ky kusht synon të mbrojë cilësinë dhe të ulë riskun që IAL-të të pranojnë studentë me mesatare të ulët thjesht për të rritur numrin e studentëve nga i cili varen dhe fondet publike që ato përfitojnë.

Për qëllime të pranimit të të interesuarve të tjerë, që kanë përfunduar shkollën e mesme para aplikimit të Maturës Shtetërore, rezultatet e kësaj të fundit, ndoshta nuk janë të krahasueshme dhe të përdorshme. Për këtë kategori studentësh IAL-të do të lejohen të ndërtojnë rregullat e tyre (transparente) për të zbatuar politika të përfshirjes dhe barazisë sociale. Numri i pritshëm i studentëve në këtë kategori, të paktën në të ardhmen e afërt, pritet të jetë i vogël.

**CIKLET E STUDIMEVE QË MBËSHTETEN NGA SKEMA FINANCIARE:** Parimet e financimit të IAL-ve aplikohen vetëm për studimet universitare të ciklit të parë (diploma Bachelor) dhe studimet e larta profesionale dyvjeçare (diploma e Studimeve Profesionale). Studimet e ciklit të dytë (Master i Shkencave apo Master Profesional) dhe të tretë (Doktoraturë) nuk do të përshihen në këtë skemë financimi por mendohet të aplikohet mbështetje financiare nëpërmjet bursave të studimit, të cilat mund të jenë bursa merite ose mbështetje financiare për studime të ciklit të dytë apo të tretë në degë/drejtime prioritare për vendin në të cilat është më e madhe nevoja për të shkolluar në nivelet master dhe doktoratë (psh shkencat albanologjike, IT, etj).

## **KREU II: MEKANIZMI I KONKURENCËS SË LIRË - TREGU I “STUDENTËVE”**

Në skemën e propozuar të financimit me bazë studentin, *IAL-të do të operojnë në një treg konkurrues për të tërhequr studentët*. Që një mekanizëm tregu në arsimin e lartë të jetë efikas, studentët (konsumatorët) duhet të jenë shumë të informuar për të marrë vendime (parimi i informimit të plotë). *Qeveria Shqiptare është e angazhuar të sigurojë që ekziston informacion i mjaftueshëm për studentët* në mënyrë që ata të njohin një program të caktuar studimi, të njohin perceptimin e përgjithshëm mbi cilësinë akademike të tij si dhe vlerësimin që vjen nga tregu i punës.

Këshilli i Akreditimit dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të përdorin mjetet e komunikimit në masë (në veçanti faqet zyrtare të internetit) për të ofruar informacion mbi statusin zyrtar të çdo programi (liçensuar apo akredituar), kjo për çdo IAL dhe jo vetëm për ata që përfitojnë nga financimi publik. Për të plotësuar informacionin zyrtar, *rankimi/renditja e IAL-ve* që do të zbatohet gjatë 2010-2011 do të ofrojë informacion lehtësisht të lexueshëm nga studentët mbi cilësinë e programeve të studimit.

Këto burime alternative informacioni do të duhet të plotësohen me informacion nga vetë IAL. Si parakusht për të përfituar nga financimi me bazë studentin, *çdo IAL-je do t'i kërkohet të bëjë një paketë informative për studentët potencialë*, si dhe të përcaktojë pika informative kontakti. Kjo paketë informative lehtësisht e kuptueshme duhet të përfshijë edhe të dhënat mbi treguesit matës të cilësisë së programeve të studimit si (i) numri i aplikantëve për çdo vit, (ii) shkalla e suksesit të të diplomuarve në Provimin e Shtetit për profesionet e rregulluara, (iii) statistika mbi punësimin e të diplomuarve, (iv) pragu minimal i notës apo pikëve të studentëve të pranuar në vitet paraardhëse, (v) përqindja e ndërprerjes së studimeve, (vi) raporti i orëve leksion /seminar, etj. *Diskutimi i gjerë me grupet e interesit do të ndihmojë për të gjeneruar ide të tjera mbi informacionin dhe transparencën e universiteteve në raport me studentët*.

Studentët janë të rinj (përgjithësisht 18 vjeç), me përvojë të kufizuar ose pa përvojë në vendime madhore. Pavarësisht informacionit dhe ndihmës nga prindërit gjatë përzgjedhjes së fushës së studimit apo universitetit, është shumë i rëndësishëm përmirësimi i shërbimit të “Këshillimit të Karrierës” për gjimnazistët.

## **KREU III: SKEMA E FINANÇIMIT ME BAZË STUDENTIN**

### **3.1. KUOTAT**

Në një mekanizëm financimi të bazuar tek studenti, *kufizimi i numrit të studentëve të cilët përfitojnë nga fondet publike* është i domozdoshëm, në të kundërt ekziston rreziku që kërkesa për fonde publike të bëhet e papërbalueshme. Nëse ky kufizim do të vendosej vetëm mbi numrin e përgjithshëm të studentëve (pa dalluar fushat e ndryshme të studimit), shpërndarja e studentëve dhe

fondeve sipas fushave të studimit do të realizohet vetëm nga vendimet individuale të studentëve. Zgjedhja e fushës së studimit nga individët do të reflektojë optimizimin e objektivave individuale dhe sinjalet që vijnë nga tregu i punës. Megjithatë këta dy faktorë nuk duhet të jenë të vetmit që përcaktojnë zhvillimin e arsimit të lartë sepse ky sektor është një e mirë publike dhe është faktor kyç në prespektivën e zhvillimit të vendit.

Kuotimi i numrit të studenteve të financuar nga fondet publike do të shprehet ***në numër studentësh për fusha studimi***. Kuotimi do të aplikohet si për Institucionet publike të Arsimit të Lartë dhe Institucionet jopublike të Arsimit të Lartë të përfshira në skemën e financimit me bazë studentin. Numri total i studentëve që do të përfitojë financim publik nëpërmjet kësaj skeme do të jetë në funksion të totalit të fondeve publike në mbështetje të arsimit të lartë.

Kuotat do të përcaktohen në grupime mjaft të gjera të fushave të studimit në krahasim me kuotimin shumë të detajuar që bëhet aktualisht (200 fusha studimi). Numri total i fushave të studimit që do të përdoret për kuotimin e numrit të studentëve nuk është përcaktuar përfundimisht, por sugjerimi fillestar i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është që të përdoren rreth ***10 fusha studimi***. Fushat e studimit do të karakterizohen nga konvergjenca akademike si dhe nga një variacion i ulët i kostos për student. Sugjerimi fillestar i fushave të studimit që do të përdoren për kuotim është si vijon:

1. Shkenca juridike dhe sociale
2. Shkenca filologjike
3. Shkenca ekonomike
4. Shkenca të edukimit
5. Shkenca teknike
6. Shkenca natyrore
7. Shkenca bujqësore, veterinare dhe pyjore
8. Shkenca të shëndetit
9. Shkenca të sportit dhe Artet
10. Shkenca të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Kuotimi do të realizohet mbi bazën e informacionit të saktë dhe analizave racionale dhe jo vetëm mbi historikun e shpërndarjes së studentëve. Tre janë faktorët kryesorë që do të mbahen parasysh në përcaktimin e kuotave;

- a. Nevojat kombëtare për forcë punëtore të kualifikuar; anketimet kombëtare të tregut të punës do të përdoren për të siguruar informacion mbi profesionet dhe aftësitë e kërkuara.
- b. Tërësia e programeve të studimit të ofruara, kapaciteti dhe cilësia e programeve të studimit për çdo IAL;
- c. Të dhënat që do të vijnë nga vetëzgjedhja dhe kërkesat e studentëve

Kuotat për çdo fushë studimi do të vendosen me një tolerance +/-5%. Nëse një IAL arrin të rekrutojë studentë (cilësorë) aq sa është kuota e vendosur +/-5%, kjo do të thotë se egziston kërkesë e lartë nga studentët dhe se kjo kërkesë duhet të reflektohet në kuotimin e vitit pasardhës. Në mënyrë të ngjashme kuotimi duhet të reflektojë paaftësinë e një IAL-je për të tërhequr studentë dhe për të plotësuar kuotat e vena në dispozicion. Përshtatja e kuotave do të reflektojë kapacitetet absorbuese për studentë të IAL-së si dhe prioritetet dhe politikat e zhvillimit në nivel kombëtar.

Përshtatja e kuotave do të bëhet në frekuenca vjetore dhe do të ndikohet nga zgjedhja e studentëve; ky mekanizëm përforcon domozdoshmërinë për mirë informim të studentëve dhe njohje të mirë të kërkesave dhe zhvillimit të tregut të punës për të diplomuarit.

IAL-të jopublike nuk do të kenë kufizime për numrin e studentëve të pa financuar nga fondet publike që do të pranojnë, megjithatë ata do të mbikqyren për ruajtjen e treguesve të cilësisë.

IAL-të publike do të lejohen të marrin studentë mbi kuotat e përcaktuar për financim, në një masë të kufizuar (ndoshta jo më shumë se 10% të kuotave) për sa kohë që këta studentë plotësojnë kriteret e vendosura nga IAL për pranimet e reja dhe nuk çenojnë treguesit e cilësisë (sipërfaqe/student, staf akademik/student etj). Kufizimi i numrit të studentëve jashtë kuotave të parashikuara për financim në IAL publike bëhet si një masë për të mbrojtur cilësinë dhe asetet publike nga mbipërdorimi. Qeveria do të vendosë një minimum të tarifës së shkollimit për studentët që nuk do të përfshihen në skemën e financimit.

### 3.2. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË VLERËN E FINANCIMIT

*Vlera e financimit për student do të variojë në përputhje me fushën e studimit.* Ndryshimet legjitime në koston për student në fusha të ndryshme studimi do të pasqyrohen në vlerën e financimit për student. Koeficientë diferencues në llogaritjen e financimit për student do të përdoren edhe për programet e studimeve të larta profesionale (dyvjeçare).

Një tjetër faktor që ndikon në koston e arsimit mbi të cilin universitetet nuk kanë kontroll *janë diferencat rajonale në kosto operacionale të universiteteve.* Ky faktor do të reflektohet në llogaritjen e financimit për student.

Përveç reflektimit të diferencave sistematike të koston për student në vlerën e financimit, Qeveria Shqiptare po mendon të përdorë *vlerën e financimit për student si sinjalizues për fushat të cilat konsiderohen si prioritet kombëtare.* Objektiva dhe prioritetet e qeverisë për sa i përket zhvillimit të arsimit të lartë do të pasqyrohen në koeficientë preferenciale në vlerësimin e financimit për student. Objektiva të tilla mund të jenë nxitja e studimeve të larta profesionale (diplomat 2-vjeçare post-secondary), zhvillimi i programeve ndërdisiplinore, nxitja e programeve të veçanta studimi në universitetet rajonale, etj.

Vlera e financimit për student, në mënyrën si llogaritet do të financojë edhe aktivitete që i shërbejnë rritjes së shkallës së kualifikimit dhe karrierës së stafit akademik. Ky fond do të vazhdojë të jetë 8% e totalit të financimit publik dhe duhet të përdoret rigorozisht për aktivitete që përmirësojnë performancën akademike. Qëllimi afatgjatë i këtij financimi është përmirësimi dhe modernizimi mësimdhënies në arsimin e lartë. Ky objektiv është pjesë edhe e Strategjisë Kombëtare për Arsimin e Lartë. Aktivitetet kryesore që do mund të financohen nga ky fond janë promovimi dhe kualifikimi akademik i stafit, specializimet dhe kërkimi shkencor. Auditimi dhe raportimi i përdorimit të këtyre fondeve do të jetë rigoroz dhe i përvitshëm.

### 3.3. IMPLIKIME TË PRITSHME NGA APLIKIMI I FINANCIMIT TË IAL-VE ME BAZË STUDENTIN

Për të përcaktuar fondet publike që përfiton çdo institucion i arsimit të lartë duhet të aplikohen një sërë faktorësh që kanë lidhje me ndryshueshmërinë e numrit të studentëve në IAL-të. Për të përcaktuar saktësisht nivelin e financimit me bazë studentin, qeveria ka nevojë për *informacion plotësisht të saktë mbi numrin e studentëve sipas fushave të studimit dhe kuotave të përcaktuara.* Ky informacion duhet të shkëmbehet lehtësisht me MASH, me kërkesën e saj, si parakusht për disbursimin e fondeve publike. Për këtë qëllim duhet të krijohet një sistem qendror elektronik i monitorimit të dinamikës së numrit të studentëve në çdo IAL dhe për të gjithë sistemin.

Aplikimi i skemës së financimit bazuar tek studenti mund të sjellë ndryshim të strukturës tradicionale të shpërndarjes së fondeve publike tek IAL-të. Është e pritshme që në fazën fillestare të ketë “të fituar” dhe “të humbur”. Në përgjithësi, do të ketë Institucione që do të mund të përfitojnë nivel financimi më të ulët se ai aktual (humbës) por do ketë Institucione që do mund të përfitojnë rritje të financimit publik. Për të ndihmuar IAL publike të përshtaten me kushtet e reja, me lëkundje të mundshme në buxhetin e tyre, qeveria parashikon të ndërhyjë për një periudhë kalimtare me instrumenta balancues duke mos lejuar ndikime negative në financim.

Në momentin që mekanizmi i ri i financimit bëhet plotësisht operacional (parashikohet një periudhë 3-vjeçare) IAL duhet të planifikojnë vetë numrin e pritshëm të studentëve dhe si rezultat dhe burimet financiare të pritshme nga një vit në tjetrin. Fondet publike që përfiton universiteti në bazë të numrit të studentëve, për shkak të diferencës në kohë të vitit buxhetor me atë akademik duhet të llogariten me një vit diferencë.

Një nga qëllimet e reformimit të mekanizmit të financimit të arsimit të lartë është të nxisë IAL publike për t’u bërë më fleksibël ndaj evolimit të kërkesës dhe nevojave të tregut. IAL-të do të inkurajohen të gjenerojnë të ardhura nga kontrata tregtare apo aktivitete të tjera; pengesat rregullatore ose ligjore për IAL-të publike do të hiqen. Shpesh, të ardhurat e krijuara nga aktivitete të tilla në IAL konsiderohen si të ardhura që i përkasin atyre personave që marrin pjesë në këtë aktivitet (stafit akademik që realizon një projekt) dhe jo universitetit. IAL-të publike do të inkurajohen të zhvillojnë rregullore të brendshme për të menaxhuar këto të ardhura.

#### **KREU IV: TARIFAT E SHKOLLIMIT DHE BURSAT E STUDIMIT**

**TARIFA E SHKOLLIMIT:** Studentët shqiptarë paguajnë tarifa shkollimi si në IAL publike ashtu dhe në ato jopublike. Reforma e financimit të Arsimit të Lartë ka gjasa të kërkojë një rritje të tarifave të shkollimit në universitetet publike dhe rënie të konsiderueshme të atyre që zbatojnë aktualisht IAL jopublike. *Qeveria do të vendosë një nivel maksimal të tarifës së shkollimit që universitetet publike mund të aplikojnë për studentët e financuar nga fondet publike.*

Ky kufizim mbi vlerën e tarifës së shkollimit vendoset pjesërisht për faktin se këto Institucione janë publike dhe ofrojnë një të mirë publike. Niveli maksimal i tarifës së shkollimit së bashku me vlerën e financimit për student do të mbulojnë koston e plotë të studimeve. Kufizimi mbi tarifën e shkollimit (në formën e një niveli maksimal) për IAL-të publike duhet të jetë i njëjtë ndërmjet institucioneve dhe fushave të studimit. Diferencimi i nivelit të financimit për Institucione dhe fusha studimi do të realizohet nëpërmjet diferencimit të vlerës së financimit për çdo student.

Në aspektin psikologjik është e rëndësishme që studentët të njohin vlerën e studimeve që ata përfitojnë. Përvoja ka treguar se motivimi dhe vlerësimi i tyre për studimet është më i lartë nëse ata njohin koston e vërtetë të tyre. Për të bërë të njohur tek ta vlerën e studimeve të tyre ***sygjerohet që tarifa e shkollimit të paraqitet si një kontribut i studentit mbi vlerën e financuar nga fondet publike.*** Ngelet për të debatuar mënyra praktike e paraqitjes dhe bërjes së njohur tek studenti i vlerës së studimeve.

Tarifa e shkollimit të IAL-ve jopublike nuk do të kenë kufizime, por efekti i konkurrencës në treg pritet të ndikojë në uljen e konsiderueshme të tyre.

Për studentët të cilët shkojnë në Institucionet publike të Arsimit të Lartë por nuk përfshihen në skemën e financimit, minimumi i tarifës së shkollimit të tyre do të vendoset i barabartë me vlerën e

financimit për student plus tarifën e shkollimit që paguajnë studentët e financuar nga fondet publike.

**BURSAT E MERITËS:** Qeveria Shqiptare do të japë *bursa merite për studentët me rezultate të shkëlqyera*, të cilat do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar koston e plotë të në një universitet publik. Bursat e meritës do t'u shpërndahen 5% të studentëve për fushë studimi me rezultatet më të mira në provimet e Maturës Shtetërore. Qeveria Shqiptare po shqyrton mundësinë që të rrisë vlerën e bursave të meritës në mënyrë që të mbulojë një pjesë të koston së jetesës për studentët, por kjo do të varet nga niveli i financimit publik për arsimin e lartë.

**BURSAT STUDIMI NË DEGË PRIORITARE:** Përveç bursave të meritës, Qeveria Shqiptare mendon të japë *një numër bursash studimi për të nxitur studimin në fusha prioritare*. Bursat sipas fushave të studimit do të jepen për studentët në ciklin e parë të studimeve si dhe për studimet e larta profesionale 2-vjecare.

**BURSAT E EKSELENCËS:** Qeveria Shqiptare do të mbështesë financiarisht studentët ekselentë që vazhdojnë ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. Fushat e studimit dhe numri i bursave të ekselencës do të jenë në varësi të prioriteteve kombëtare për kualifikime të tilla (psh. mbështetja e studimeve pas universitare në mësuesi, teknologji informacioni apo shkencat e natyrës ).

## **KREU V: SISTEMI I KREDISË STUDENTORE**

Të gjithë studentët (pa bursa) duhet të paguajnë tarifën e tyre të shkollimit dhe të sigurojnë koston e jetesës gjatë studimeve. Qeveria Shqiptare do të ndërtojë një sistem kredidhënie më anë të të cilit studentët mund të marrin kredi të buta për të paguar tarifën e tyre – ndoshta edhe një kontribut për koston e jetesës. Të gjithë studentët që plotësojnë kushtet, në IAL publike dhe jo-publike duhet të kenë të drejtën të marrin kredi studentore (deri në një shumë maksimale të përcaktuar).

Shkalla e subvencionit të interesave si dhe skema e kredidhënies (nese do të realizohet nga banka te nivelit të dytë apo nga një agjenci publike) janë në shqyrtim. Në rrethana të caktuara, qeveria mund të përgatitet të amnistojë një pjesë të kredisë ose të gjithën, psh në rastet kur është e pamundur për arsye madhore shlyerja e kredisë, politika në mbështetje të punësimit në zona të thella rurale etj.

Studentët do të fillojnë të shlyejnë kredinë e tyre brenda një ose dy vitesh që nga diplomimi i tyre; shpejtësia me të cilën ata duhet të shlyejnë kredinë do të varet nga niveli i të ardhurave të tyre. Mënyra më e mirë për të identifikuar nivelin e të ardhurave dhe pagesën periodike të kredisë do të ishte sistemi i vetëdeklarimit dhe tatimit të të ardhurave personale.

Studentët nga familjet me të ardhura të kufizuara do të kenë prioritet në marrjen e kredisë studentore në po të njëjtën mënyrë dhe kushte si të gjithë studentët e tjerë. Shlyerjet e kredive të tyre do të fillojnë vetëm pasi ata të nxjerrin të ardhura, duke mos ndikuar aspak në ekonominë familjare të tyre. Vendet e tjera që kanë zbatuar një skemë të tarifave dhe kredive studentore kanë konstatuar se nuk ka evidenca të reduktimit të pjesëmarrjes së studentëve nga familje me të ardhura të kufizuara.

## **KREU VI: FINANCIMI I AKTIVITETEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR**

Financimi me bazë studentin do të mbulojë shpenzimet e mësimdhënies në IAL. Mësimdhënia akademike kërkon një formë mbështetje financiare nëpërmjet së cilës akademikët realizojnë punë kërkimore dhe marrin pjesë në seminare dhe konferenca të ndryshme. Ky aktivitet është i lidhur

ngushtë dhe i shërben mësimdhënies dhe si e tillë mbulohet nga financimi me bazë studentin. Në mënyrë të ngjashme, puna administrative është pjesë e detyrimeve të të gjithë stafit akademik dhe është gjithashtu e përfshirë në financimin me bazë studentin.

Strategjia e Qeverisë është që kërkimi akademik i financuar nga fondet publike të kufizohet në shtatë fusha të rëndësishme kombëtare. Aktualisht projektet kërkimore paraqiten pranë Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Informacionit (AKTI), vlerësohen mbi bazën e konkureshmërisë dhe përzgjidhen për financim. Çdo Institucion, publik apo jopublik – si dhe organizata të tjera, mund të aplikojnë për projekte të tilla kërkimore. Do të ishte mjaft e vlefshme që universitetet rajonale të aplikojnë për financime të tilla duke ndërtuar aktivitetin kërkimor në funksion të zhvillimit rajonal.

Financimi i ofruar nga AKTI për këto projekte kërkimore mbulon përgjithësisht kostot e drejtpërdrejta të kërkimit, por pa kontribut për shpenzimet e pagave të personelit kërkimor dhe ndihmës. Nëse buxheti i kërkimit rritet në mënyrë të konsiderueshme, duhet të rishikohet përfshirja e një pjese të pagesës së stafit si dhe kostove administrative.

Më anë të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, një numër institutesh kërkimore u shkrinë me universitetet përkatëse; tani ekziston një projekt i planifikuar për të vlerësuar se si institutet kërkimore mund të integrohen më mirë me universitetet “pritëse”. Stafi akademik i këtyre instituteve kërkimore pritet t’i kushtojë rreth 30% të kohës mësimdhënies në universitet, shpenzim që duhet të mbulohet nga financimi i bazuar tek studentin. Financimi i aktivitetit kërkimor të tyre realizohet nga fondet publike jashtë skemës së financimit me bazë studentin. Qeveria synon të përcaktojë financimin e instituteve kërkimore mbi bazën e treguesve të performancës së tyre kërkimore (për shembull, publikimet). Tërësia e treguesve vlerësues të instituteve kërkimore është duke u diskutuar dhe opinione mbi këtë çështje janë të mirëpritura.

## **KREU VII: MENAXHIMI DHE QEVERISJA E UNIVERSITETEVE**

Sistemi i financimit të universiteteve me bazë studentin kërkon që Institucionet publike të Arsimit të Lartë të zhvillojnë mënyra të reja të menaxhimit dhe qeverisjes. Universitetet duhet të njohin kostimin e aktiviteteve të tyre kryesore dhe të zhvillojnë buxhetimin e aktiviteteve të tyre me një limit të paracaktuar të burimeve financiare. Ato nuk do të kenë udhëzime mbi kategoritë e shpenzimeve, ndërkohë që do t’u duhet të monitorojnë dhe kontrollojnë shumë aspekte të shpenzimeve. Universitetet u nevojiten sisteme menaxhimi financiare efektive dhe operacionale përpara se të aplikohet skema e financimit me bazë studentin. *Qeveria do të përcaktojë indikatorët e menaxhimit financiar dhe do të realizojë kontrollin dhe monitorimin e tyre për të siguruar që universitetet janë duke u përshtatur me sistemin e ri të financimit.*

Reforma e financimit të arsimit të lartë do të kërkojë ndryshime në qeverisjen dhe menaxhimin e universiteteve që janë shumë më të gjera se reformimi i financave. Një nga qëllimet e kësaj reforme është që të rrisë shkallën e konkurrencës midis universiteteve në mënyrë që të rritet cilësia dhe diversiteti i studimeve të larta. Që Institucionet publike të Arsimit të Lartë dhe ato jopublike të kenë mundësi të konkurojnë në mënyrë të “drejtë” kuadri rregullator mbi të cilin universitetet funksionojnë duhet të jetë gjerësisht i krahasueshëm. Aktualisht situata nuk është e tillë, kuadri rregullator mbi të cilin menaxhohen financat, kontraktimet, prokurimet, termat e punësimit, pagesës dhe promovimit të stafit akademik ndryshojnë mjaft.

Kjo do të thotë që Institucionet publike të Arsimit të Lartë do të kenë nevojë për një autonomi financiare dhe administrative më të gjërë se aktualisht, por të balancuar me llogaridhënien. Për të

ndërtuar autonomi dhe përgjegjshmëri më të lartë të Institucioneve publike të Arsimit të Lartë, qeveria do të bëjë ndryshimet e duhura ligjore dhe rregullative.

Përsa i përket universiteteve, edhe ato do duhet të bëjnë ndryshime në sistemin e menaxhimit dhe qeverisjes në mënyrë që të jenë të aftë të operojnë në mënyrë efikase në kushtet e konkurrencës dhe autonomisë së përgjegjshme. Ndryshimet kryesore të universiteteve kanë të bëjnë me:

1. **Planifikimin Strategjik** – përcaktimin e drejtimit strategjik të universitetit, me një vision që reflekton objektivat afatgjata të institucionit.
2. **Planifikim, buxhetim dhe financat** - zhvillimi i planeve afatgjatë dhe përcaktimi i objektivave dhe qëllimeve, vendosja e prioriteteve dhe përcaktimi i burimeve financiare sipas tyre, procesi i planifikimit i hapur dhe gjithëpërfshirës.
3. **Menaxhimi dhe përgjegjshmëria** - vendimmarrje e thjeshtë, transparente dhe e justifikuar, menaxhimi i lartë zgjidhet në bazë të përputhshmërisë me aftësitë dhe kualifikimet që kërkon një pozicioni i tillë, përcaktim i qartë i nivelit të autoritetit.
4. **Kurset dhe Studentët** - kurrikula, përcaktimi i qartë i rezultateve të të mësuarit dhe metodave të vlerësimit; proceset e zhvillimit dhe rishikimit të një kursi; zhvillimi i aftësive të mësimdhënies dhe përdorimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënie.
5. **Stafi** - përcaktimi i kriterëve dhe procesit të përzgjedhjes dhe promovimit të stafit akademik; metoda të vlerësimit dhe të zhvillimit të stafit akademik etj.

Eksperiencia e vendeve të tjera sugjeron se Institucionet publike të Arsimit të Lartë do të kenë nevojë për një periudhë kohe për të zhvilluar një sistem qeverisjeje efektiv në funksion të autonomisë dhe përgjegjshmërisë. Ndryshimet në shkallën e autonomisë së universiteteve do të zbatohen në mënyrë graduale dhe në përputhje me shkallën e përgjegjshmërisë së tyre. Reformimi i menaxhimit dhe qeverisjes së Institucioneve publike të Arsimit të Lartë do të mbështetet nga qeveria nëpërmjet “Fondit për Zhvillimin Strategjik të Institucioneve të Arsimit të Lartë”.

## **KREU VIII: FONDI PËR ZHVILLIMIN STRATEGJIK TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

Përveç financimit të universiteteve me bazë studentin, ka dy aspekte të veprimtarisë së universiteteve të cilat do të kërkojnë burime financimi specifike. ***E para ka të bëjë me aktivitete shumë specifike për një universitet dhe e dyta ka të bëjë me mbështetjen e politikave të zhvillimit të cilat qeveria vendos të implementojë.*** Do të jetë objektivi i fondeve të zhvillimit strategjik për të financuar aktivitete të tilla.

Një drejtim kryesor i mbështetjes nga ky fond është financimi për **investimet kapitale në IAL-të publike**. Universitetet publike do të ftohen për të parashtruar kërkesat dhe nevojat e tyre për investime kapitale në mënyrë të argumentuar dhe të kostuar. Kërkesat do të shqyrtohen, vlerësohen si projekte konkurruese, duke përgjedhur për financim më të mirët. Përveç kësaj, qeveria po planifikon, brenda mundësive, t’u ofrojë universiteteve publike truall për ndërtimin e kampuseve universitare në mbështetje të politikave të zhvillimit rajonal.

Një tjetër kërkesë për financim të veçantë mund të jetë për një fond kombëtar trashëgimie i cili u jepet universiteteve, për shembull, për të ruajtur një ndërtesë historike ose një koleksion (psh një kopësht botanik, etj).

Do të ekzistojnë gjithmonë iniciativa politike që qeveria do t’i promovojë, për të cilat nevojiten burime financiare shtesë. Iniciativa të natyrës reformuese dhe politike janë dinamike dhe mund të

ndryshojnë me kalimin e kohës. Ky dokument konsultimi publik mbi reformën e financimit të arsimit të lartë për momentin ka identifikuar dy çështje të cilat do të kërkonin mbështetje nga fondi i zhvillimit strategjik të arsimit të lartë (i) *rritjen e cilësisë në ato Institucione Publike të Arsimit të Lartë që kanë tregues më të ulët cilësie se niveli i përcaktuar për financim dhe (ii) reformimi i qeverisjes dhe menaxhimit të universiteteve e nevojshme për rritjen e autonomisë dhe përgjegjshmërisë së tyre.*

Strategjia Kombëtare e Arsimit të Lartë (Shtator 2008-2013) ka identifikuar si sfidë të politikëbërjes shndërrimin e **universiteteve rajonale në qendra të zhvillimit rajonal, me një rol aktiv në zhvillimin dhe promovimin e zhvillimit të komuniteteve dhe ekonomisë lokale.** Çdo universitet rajonal do të ftohet të aplikojë në një format të caktuar për financim të projekteve si ndërmarja nga ana e tyre e kërkimeve të aplikuara ose programe trajnimi për bizneset lokale. Një tjetër objektivi mund të jetë zhvillimi i programeve dhe drejtimeve të reja që kanë interes kombëtar. Fonde për këtë qëllim do të jenë në dispozicion të të gjithë universiteteve publike dhe jopublike. Qeveria dëshiron të inkurajojë universitetet të bashkëpunojnë; projekte të tilla do të kenë prioritet në përzgjedhje dhe financim. Me interes do të ishte zhvillimi i programeve ndërdisiplinore të studimit. Zhvillimi i programeve dy vjeçare të studimeve të larta profesionale, kjo sidomos në universitetet rajonale, është gjithashtu e rëndësishme. Kjo domozdoshmëri ka qenë evidentuar edhe në Memorandumin e Bashkëpunimit Ekonomik, një raport prestigjioz i përgatitur nga ekspertë të Bankës Botërore. Deri tani, vetëm Universiteti i Durrësit ofron programe të tilla studimi, në një fakultet të ri të hapur me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare. Qeveria e pranon se hapja e programeve të tilla studimi mund të hasë në mospëlqimin e akademikëve tradicionale, por ato janë të domozdoshme për të ardhmen e vendit, dhe është e vendosur të inkurajojë zhvillimin e tyre.

Këto fonde do t'u vihen në dispozicion universiteteve publike dhe private, në bazë të mekanizmit të konkurrencës, duke ndihmuar Institucionet të hartojnë, marketojnë dhe implementojnë programe 2-vjeçare të studimeve të larta profesionale. Këto fonde mund të mbulojnë kostot e zhvillimit të programit, promovimin dhe krijimin e lidhjeve me punëdhënësit lokalë si dhe investimet kapitale të nevojshme për të krijuar klasat e praktikës dhe mësimdhënies. Fondet për zhvillim strategjik mund të financojnë shtimin e stafit të orientuar në mësimdhënien e integruar me praktikën si dhe në infrastrukturë. Qeveria duhet gjithashtu të mendojë për mënyra si të motivojë punëdhënësit të angazhohen në sipërmarrje të kësaj natyre. Në momentin që këto programe janë operacionale, kostoja e tyre do të mbulohet nga skema e financimit me bazë studentin.

## **Në përfundim**

Qeveria Shqiptare do të përgatisë një plan veprimi për të ndërmarrë reformën financiare në arsimin e lartë, platforma e plotë e së cilës do të ndërtohet vetëm mbas një diskutimi të gjerë publik me grupet e interesit. Zbatimi i reformës së financimit do të shoqërohet me instrumenta monitorues të kujdesshëm si dhe me ngritje kapacitetesh në të gjithë spektrin institucional që ajo përfshin.